V E N D I M
Nr.363,datë 27.5.2001

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË TOKËS TRUALL QË PREKET NGA NDËRTIMI I FUSHËS SË FUTBOLLIT NË QYTETIN E ÇOROVODËS DHE PËR DHËNIE FONDI BASHKISË SË ÇOROVODËS PËR NDËRTIMIN E KËSAJ FUSHE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 7 të ligjit nr.8718, datë 19.12.1999 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik, në favor të Ministrisë së Pushtetit Vendor të pasurive të paluajtshme të pronarëve që preken nga ndërtimi i fushës së futbollit në qytetin e Çorovodës.
2. Pronarët e këtyre pasurive të paluajtshme të kompesohen me vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në tabelën e cila i bashkëlidhet këtij vendimi e që arrin shumën 6 500 000 (gjashtë milionë e pesëqind mijë) lekë.
3. Shpronësimi të fillojë me çeljen e fondit.
4. Bashkisë së Çorovodës, në buxhetin e miratuar për vitin 2001, t'i shtohet, në zërin "Investime", fondi prej 19 000 000 (nëntëmbëdhjetë milion) lekësh për ndërtimin e kësaj fushe.
5. Fondet për kompesimin e pronarëve dhe për ndërtimin e fushës së futbollit, që arrin vlerën e përgjithshme 25 500 000 (njëzetë e pesë milionë e pesëqind mijë) lekë, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
6. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Lokal dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Lista emërore e pronarëve që preken nga ndërtimi i fushës së sportit në qytetin e Çorovodës.
LLoji i pasurisë: tokë truall

1	2			3	4	5
Nr	Pronarë			Sipërfaqe m2	Çmimi lekë/m2	Vlera e truallit lekë /m2
	Emër	Atësi	Mbiemër			
1	Teki	Selam	Koprencka	325	1000	325 000
2	Mysel	Selam	Koprencka	1300	1000	1 300 000
3	Ylli	Selam	Koprencka	1462	1000	1 462 000
4	Namik	Selam	Koprencka	1527	1000	1 527 000
5	Faik	Selam	Koprencka	1886	1000	1 886 000
	Shuma			6 500	1000	6 500 000